



Република Северна Македонија Republika e Maqedonisë së Veriut
Општина Тетово Komuna e Tetovës
Дервиш Цара,68 Dervish Cara, 68
1200,Тетово 1200,Tetovë
E: info@tetova.gov.mk

Në bazë të nenit 4 paragrafi 4 nga Rregullorja për përcaktimin e mënyrës së pagesës dhe të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga kafshimi i qenve endacak,nr.08-12159/20 nga 28.10.2022 viti,të shpallur në,,Fletoren zyrtare të komunës së Tetovës”nr.14,Komuna e Tetovës shpall

THIRRJE PUBLIKE

Për zgjedhjen e anëtarëve të jashtëm të Komisionit për veprim sipas kërkesave për kompensim të dëmit të shkaktuar nga kafshimi i qenve endacak ndaj qytetarëve në territorin e Komunës së Tetovës

1.Lënda

1.1 Lënda e Thirrjes publike është zgjedhja e anëtarëve të jashtëm të Komisionit për veprim sipas kërkesave për kompensim të dëmit të shkaktuar nga kafshimi i qenve endacak ndaj qytetarëve në territorin e komunës së Tetovës (në tekstin e mëtejme:Komisioni),edhe atë:

- 1 (një) anëtarë nga rrahët e mjekëve të licencuar traumatolog dhe
- 1 (një) anëtarë nga rrahët e mjekëve të licencuar nga fusha e psikiatrisë.

1.2 Mandati i anëtarëve të Komisionit është në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet.

1.3 Anëtarëve të Komisionit,u paguhet kompensim mujor për pjesëmarrje në punën e Komisionit,kompensin në lartësi prej 8000,00 denarë,në shumë neto.

2. Kushtet

2.1 Kandidatët nga nënpika 1.1 në Thirrjen publike,duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë Veriore,
- Të posedoj licencë të vlefshme pune të lëshuar nga Dhoma e mjekëve të Republikës së Maqedonisë Veriore,
- Të ketë minimum 3 (tre) vjet përvojë pune si mjek specialist në fushën përkatëse,në përputhshmëri me nënpikën 1.1 nga Thirrja publike.

2.2 Përvoja në trajtimin e plagëve dhe lëndimeve nga kafshimi i qenve (traumatolog) ose përvojë pune (diagnostifikim) me persona të cilët kanë pësuar frikë dhe dhimbje emocionale nga kafshimi i qenve (psikiatër), do të konsiderohet si përparësi.

3. Mënyra e paraqitjes në Thirrjen publike.

3.1 Personat të cilët i plotësojnë kushtet nga pika 2 të kësaj Thirrje, është e nevojshme që deri te komuna e Tetovës të dorëzojnë:

- Dokument të vlefshëm për identifikim personal (kopje),
- Kopje nga licenca e vlefshme për punë lëshuar nga Dhoma e mjekëve të Republikës së Maqedonisë Veriore,
- Dëshmi se ka minimum 3 (tre) vjet përvojë pune si mjek specialist traumatolog ose si mjek specialist nga fusha e psikiatrisë në institucion shëndetësor-vërtetim nga institucioni shëndetësor,
- Biografi në të cilën do të theksohet përvoja profesionale lidhur me trajtimin e plagëve dhe lëndimeve nga kafshimi i qenve ose puna (diagnostifikim) me persona të cilët kanë pësuar frikë dhe dhimbje emocionale nga kafshimi i qenve (psikiatër).

4. Mënyra e realizimit të Thirrjes publike

4.1 Për realizimin e Thirrjes publike, Kryetari i komunës së Tetovës formon Komision për realizimin e Thirrjes publike për zgjedhje të anëtarëve të jashtëm të Komisionit për veprim ndaj kërkesave për kompensim të dëmit të shkaktuar ndaj qytetarëve të komunës së Tetovës nga kafshimi i qenve endacak (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni për realizim të Thirrjes publike).

4.2 Komisioni për realizimin e Thirrjes publike, në bazë të dokumentëve të dorëzuara nga personat të cilët kanë aplikuar, do paraqet propozim për zgjedhje të anëtarëve të Komisionit deri te Kryetari i Komunës së Tetovës.

4.3 Nëse paraqitet nevoja Komisioni për realizimin e Thirrjes publike, personat të cilët janë paraqitur në Thirrjen publike mund t'i thirr në intervist.

4.4 Kryetari i komunës së Tetovës me propozim të Komisionit për realizim të Thirrjes publike, do sjellë Aktvendim për formimin e Komisionit për veprim ndaj kërkesave për kompensim të dëmit të shkaktuar nga kafshimi i qenve endacak ndaj qytetarëve në territorin e komunës së Tetovës.

5. Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletëparaqitjeve

5.1 Thirrja publike zgjat 15 ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore dhe në veb-faqen e Komunës së Tetovës.

5.2 Fletëparaqitja bashkë me dokumentacionin duhet të dorëzohen deri te Komuna e Tetovës përmes postës në adresë: Komuna e Tetovës, rr. "Dervish Cara" nr.68, ose në arkivin e komunës së Tetovës, çdo ditë pune nga 10.00 deri 15.30, dhe me shënim: „Thirrja publike për zgjedhjen e Komisionit për kompensim të dëmit të shkaktuar nga qent endacak”.

Fletëparaqitjet dorëzohen në zarf të mbyllur pa emërtim të subjektit i cili e paraqet fletëparaqitjen.

Fletëparaqitjet e parregullta çka nuk dorëzohen në mënyrën e paraparë të Thirrjes publike, gjegjësisht përmbajnë të dhëna jo të sakta dhe dokumentacion i pakompletuar, sidhe ato çka nuk dorëzohen në afatin e paraparë, nuk do të shqyrtohen.

Pyetje për sqarim në lidhje me Thirrjen publike, personat e interesuar mund të paraqesin deri te Sektori për punë juridike.

Kontakt tel: 070/629-974 dhe e-mail adresa: juristi_do@hotmail.com

KOMUNA E TETOVËS

Kryetar,

Bilall Kasami

